

# EPOKA

## ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7057  
E shtunë, 25 nëntor 2023  
Çmimi 0.50

Hyn në fuqi armëpushimi  
i përkohshëm në  
luftën në mes të Izraelit  
dhe Hamasit | FAQE 3



Në ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## GËRVALLA: DRAFT-STATUTI I ASOCIACIONIT S'ËSHTË SHUMË<sup>F. 4-5</sup> I MIRË, POR ËSHTË NJË BAZË E MIRË PËR TË PUNUAR ME TË



Ministria e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, ka thënë të premten se draft-statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nuk është shumë i mirë në përbajte, por një bazë e mirë për të punuar me të. Ajo ka

theksuar se ky draft nuk ofron asnjë lloj autonomie për veriun e Kosovës. "Drafti ka mjaft sfida, respekton shumë prej shqetësimeve tonë në të kaluarën dhe mendoj se është një bazë e mirë për të punuar me të. Ju

siguroj se nuk ka asnjë tentativë, asnjë përpjekje, asnjë vullnet dhe as dëshirë të kësaj qeverie, në përgjithësi të institucioneve për të pranuar drafte të cilat janë në dëme të Kosovës", është shprehur Gërvalla

**NË MUNGESË TË  
TRANSPARENCEΣ DHE  
LLOGARIDHËNIES  
BESUESHMËRIA NË  
GJYKATËN SPECIALE  
ËSHTË NË PIKËPYETJE!**

Reagim i KMDLNj-së | FAQE 9



**DIPLOMATJA  
BELGE NË  
PRISHTINË:  
NORMALIZIMI,  
RRUGA E VETME  
PËR INTEGRIMIN  
E PALËVE NË BE**



**RENOVA**  
PUTZ

Maqedoni  
Xheqisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj

E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.

**NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE**  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË



**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
[info@kolegjibiznesi.com](mailto:info@kolegjibiznesi.com)  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122

Internet Website,  
Marketing...

## AKTUALE



**KURTI: I TAKON BE-SË TA PUBLIKOJË  
DRAFT-STATUTIN E ASOCIACIONIT** F. 5

**EULEX-I PËRFORCON KAPACITETIN  
KËSHILLUES DHE MONITORUES PËR  
NË VERI** F. 7

**DIPLOMOJNË 45 ZYRTARE  
KORREKTUESE** F. 3

## EKONOMI



**UNIONI I BIZNESEVE  
SHQIPTARO-GJERMANE  
HAP ZYRË NË KOSOVË** F. 8

**SHAHINI: NË VITIN 2024 PRITET QË  
RRETH 150 MIJË QYTETARË TA  
BRAKTISIN KOSOVËN** F. 8

## SPORT



**BALLKANI, I PAGUESHËM NË  
SUPERLIGË** F. 10

## Ndotja e ajrit ishte "përgjegjëse për më shumë se 250 000 vdekje" në Evropë

**SARAJEVË, 24 NËNTOR** - Grimcat e ndotura të imta të ajrit kanë shkaktuar vdekjen e më shumë se 250 000 personave në Bashkimin Evropian më 2021, u tha në një raport të Agjencisë Evropiane për Mjedis (EEA), të publikuar më 24 nëntor.

Grimcat e imta apo PM2.5 iu referohen grimcave që kryesisht krijojnë nga tymi që lirohet nga makinat dhe termocentralet me qymyr. Këto grimca të imta mund të hyjnë thellë në traktin respirator, duke shkaktuar rrezik që

njerëzit të preken nga bronkiti, astma dhe sëmundje të mushkërive. "Sipas vlerësimive të fundit të EEA-së, të paktën 253 000 vdekje në BE më 2021 u janë atribuuar ekspozimit ndaj grimcave PM2.5, që ishin të ndotura përtej nivelit të rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë", u tha në raportin e kësaj agjencie të BE-së. Agjencia tha se këto vdekje "ka qenë e mundur që të shmanget... nëse përqendrimet e grimcave të

imta do të ishin në nivelin e rekomandimeve të OBSh-së". Raporti paraqet shifra më të larta të vdekjeve krahasuar me vitin 2020, kur për shkak të ndotjes së ajrit ishte vlerësuar se kishin vdekur 238 000 persona.

Sipas Agjencisë Evropiane për Mjedis, rritja e numrit të vdekjeve mund të shpjegohet me rritjen e ekspozimit ndaj ndotësve dhe me rritjen e mortalitetit në Evropë, kryesisht për shkak të pandemisë Covid-19.



## Hyn në fuqi armëpushimi i përkohshëm në luftën në mes të Izraelit dhe Hamasit

**JERUSALEM, 24 NËNTOR** - Një armëpushim i përkohshëm në luftën në mes të Izraelit dhe Hamasit ka hyrë në fuqi të premten, duke i hapur rrugën shkëmbimit të dhjetëra pengjeve të mbajtur nga luftëtarët e grupit radikal në Gazë, me palestinezë të burgosur në Izrael, raporton Associated Press.

Nuk është raportuar për luftime në orët e para pas fillimit të armëpushimit.

Ndërprerja e luftimeve ka ofruar njëfarë lehtësimi për 2.3 milionë banorët e Gazës, të cilët janë përballur me bombardime të pareshta izraelite prej javësh, si dhe për familjet në Izrael, të cilat frikohen për fatin e më të dashurve të tyre, të marrë pengjatë sulmit të 7 tectorit nga Hamasi - i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian - i cili nxiti luftën.

Armëpushimi ka nisur në orën 7.00, sipas kohës lokale (6:00 sipas kohës në Evropë), dhe pritet të zgjasë të paktën katër ditë.

Gjatë armëpushimit, Hamasi është zotuar se do t'i lirojë të paktën 50 prej rreth 240 pengjeve që i ka marrë gjatë sulmit vdekjeprurës të 7 tectorit në Izrael. Në anën tjetër, Izraeli pritet t'i



lirojë tre të burgosur palestinezë për çdo peng të liruar nga grupi ekstremist palestinez. Hamasi ka thënë se Izraeli do t'i lirojë 150 të burgosur palestinezë.

Lirimet pritet të ndodhin në fazë, gjatë katër ditëve të ardhshme.

Pak pas hyrjes në fuqi të armëpushimit, kamionët me karburante dhe me furnizime të tjera u panë duke hyrë në Gazë nga pika kufitare me Egjiptin, Rafah, teksha marrëveshja lejon një hyrje të shtuar të ndihmave për

civilët që po përballen me mungesë të ushqimit, ujut, ilaçeve dhe energjisë elektrike.

Marrëveshja përmëpushim dhe lirim pengjesh e të burgosurish ishte arritur pas javësh negociata të tensionuara indirekte, teksha Katari, ShBA-ja dhe Egjipti shërbyen si ndërmjetës.

Armëpushimi shënon ndërprerjen e parë serioze të luftimeve, që kur Izraeli i shpalli luftë Hamasit shtatë javë më parë. Rreth 1 200 njerëz janë vrarë nga

sulmuesit e Hamasit në Izrael, më 7 tector, sipas autoriteteve izraelite. Izraeli është kundërëpërgjigjur me sulme masive ajrore dhe një ofensivë tokësore, duke shkatërruar pjesë të mëdha të Gazës dhe duke vrarë të paktën 13 000 palestinezë, sipas autoriteteve shëndetësore në territorin e qeverisur nga Hamasi.

Izraeli ka vazhduar të bombardojë objektiva gjatë natës, para armëpushimit dhe, po ashtu, ka shkatërruar tunele në zonën e

spitalit Shifa, më i madhi i Gazës, ka njoftuar ushtria.

Më parë, këtë javë, Izraeli ka shfaqur një tunel dhe dhoma që, sipas zyrtarëve të saj ushtarake, përbën një qendër të madhe e të fshehtë të Hamasit përfundi spitalit. Hamasi dhe stafi i spitalit kanë mohuar pohimet e Izraelit se Shifa përdorej si qendër komanduese e luftëtarëve.

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, është zotuar se do ta vazhdojë luftën kundër grupit radikal palestinez, pasi armëpushimi të skadojë, për t'i shkatërruar kapacitetet ushtarake të Hamasit, për t'i dhënë fund qeverisjes së tij 16-vjeçare në Gazë dhe për t'i kthyer të gjitha pengjet që po mbahen në Gazë. "Në do të vazhdojmë derisa t'i arrijmë të gjitha objektivat tona", ka thënë Netanyahu, duke shtuar se ia ka përcjellë të njëjtën porosi presidentit amerikan, Joe Biden, gjatë një bisede telefonike. Uashingtoni i ka ofruar Izraelit mbështetje të gjerë ushtarake dhe diplomatike që nga fillimi i luftës. Ministri i Mbrojtjes i Izraelit, Yoav Gallant, është cituar t'u ketë thënë trupave të enjten se pushimi i tyre do të jetë i shkurtër, dhe se lufta do të vazhdojë me intensitet edhe të paktën dy muaj të tjerë.

## Shkencëtarët në Brazil identifikojnë një specie të re të dinozaurëve

**BRAZILIA, 24 NËNTOR** - Shërbimi gjeologjik në Brazil tha më 23 nëntor se ka zbuluar një specie të re të dinozaurëve, një kafshë të shpejtë që kishte jetuar në shkretëtirë gjatë periudhës së hershme të Kretakut.

Specia e re, e quajtur Farlowichnus rapides, ishte një kafshë e vogël mishngrënëse e gjatë 60-90 centimetra, sipas hulumtuesve. Zbulimi u publikua në revistën shkencore "Cretaceous Research". "Nga një distancë

e madhe në mes të gjurmëve të këmbëve që kemi gjetur, është e mundur të konkludohet se ai ishte një zvarranik shumë i shpejtë që vraponte nëpër shkretëtirë", tha Shërbimi Gjeologjik përmes një deklarate.

Periudha e hershme e Kretakut daton nga 100 deri në 145 milionë vjet më parë. Fosilet e dinozaurëve në Brazil fillimisht u gjetën në vitet '80 nga prifti dhe paleontologu italian Giuseppe Leonardi në qytetin Ararakuara në shtetin

e São Paolos.

Leonardi duroi një nga mostrat e gjurmëve që u gjetën në formacionin e quajtur Botukatu, që është një grup shkëmbinjsh që është formuar nga shkretëtira e lashtë për Muzeun e Shkencave të Tokës më 1984.

Gjurmët që janë gjetur në Brazil dallojnë nga gjurmët e gjetura të dinozaurëve në pjesë të tjera të botës, ka thënë paleontologu i Muzeut të Shkencave të Tokës në Brazil, Rafael Costa.



# Diplomatja belge në Prishtinë: Normalizimi, rruga e vetme për integrimin e palëve në BE

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Ministrja e Punëve të Jashtme e Belgikës, Hadja Lahbib, në një konferencë të përbashkët për medie në Prishtinë me kryediplomatën e Kosovës, Donika Gërvalla, ka thënë se normalizimi i marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë është mundësia e vetme për integrim evropian të të dyja vendeve. "Kemi biseduar për dialogun në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Janë bërë hapa domethënës për normalizimin e raporteve dhe është shumë e rëndësishme të mos ketë tensione. Normalizimi është rruga e vetme për marrëveshje dhe për integrimin e të dyja palëve në Bashkimin Evropian", ka deklaruar Lahbib pas takimit me Gërvallën. Ajo ka thënë se në këto kohë sfiduese është "në interesin tonë parësor që të qëndrojmë sa më afër që të jetë e mundur, kështu siç jemi tanë". Jashtë kësaj, kryediplomatja belge tha të jetë e "kënaqur" për lidhjet e forta në mes të dy vendeve, pra Kosovës dhe

Belgikës. "Belgjika ishte një nga vendet e para që ka njohur pavarësinë e Kosovës në vitin 2008 dhe kemi punuar në shumë çështje të ndryshme", potencoai ajo, teksa përmendi edhe diasporën e Kosovës atje, për të cilën tha se "janë bërë pjesë e shoqërisë belge duke e pasuruar edhe më tej", tha Lahbib.

Nga ana tjetër, Gërvalla, në këtë konferencë tha ta ketë falenderuar homologen e saj blese "për përkushtimin e Mbretërisë së Belgikës për t'i ndihmuar Kosovës gjatë gjithë rrugës së shtetndërtimit të saj dhe, gjithashtu, për partneritetin e sinqertë dhe partneritetin e fortë që i lidh dy vendet tona". "Jemi këtu për të bërë një hap më tej për t'i thelluar marrëdhëniet tona", ka thënë Gërvalla, derisa ka treguar edhe për temat që kanë biseduar me Lahbib. "E informova rreth progresit që Kosova ka bërë në fushën e sundimit të ligjit, në fushën e zhvillimit ekonomik, në fushën e reformave institucionale dhe



reformat në përgjithësi në vendin tonë", ka thënë Gërvalla.

Përveç këtyre, Gërvalla tha se subjekt diskutimi kanë qenë edhe sfidat e sigurisë, "ato

gjeopolitike dhe ato të rajonit tonë", "Jo vetëm të Kosova po përballet me sfida të shumta për shkak të sjelljes tejet agresive të fqinjët të saj (Serbisë), por edhe Evropa në

përgjithësi, e gjithë botë perëndimore, përballet me rreziqe të cilat vetëm të bashkuar mund t'i përballojmë", ka pohuar ministrja Gërvalla.

## Diplomojnë 45 zyrtare korrektuese

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - "Shënim i përvjetorëve të institucioneve ka rëndësinë e veçantë, kur progresi i tyre është evident, kur efikasiteti i shërbimeve është drejt lartësishë së dëshirueshme, kur ne mburremi me këto suksese, dhe inkurajohemi për më shumë punë në të ardhmen që na pret", u shpreh kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në ceremoninë e 24-vjetorit të Themelimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës si dhe diplomimit të gjeneratës së 43-të të zyrtarëve korrektues. Në fjalën e tij, kryeministri Kurti tha se Shërbimi Korrektues është institucion i cili duhet ta garantojë sigurinë e seclit të dënuar, dhe mundësinë e korrektimit të individëve të cilët në të kaluarën kanë bërë veprime të gabuara apo të tilla të cilat sanksionohen me ligjet e Republikës së Kosovës. Në këtë ceremoni, para shumë të pranishmëve, kryeministri shtoi se në qeverisjen tonë kemi miratuar Reformën Ligjore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, e cila avancon shërbimet ndaj të burgosurve dhe të drejtat e tyre. Po ashtu, kemi shtuar kapacitetet dhe mundësitë për ngritje profesionale përmes trajnimeve adekuate për personelin. Teksa foli edhe për Ligjin për



Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ai tha se është paraparë reforma lidhur me trajtimin e personave të privuar nga liria, të drejtat dhe përfitimet që do t'u takojnë, sikurse ditët e pushimit jashtë Institucionit Korrektues

(14 ditë brenda vitit), kalimin e kohës në hapësira të veçanta për të gjithë të dënuarit, lirimin e parakohshëm në 3, 6, apo 9 muaj, varësisht nga vlerësimi dhe përbushja e kritereve që arrin i dënuari.

Ndërkaq përmes Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës, kryeministri Kurti theksoi se është rregulluar statusi, parimet, përgjegjësitet, menaxhimi dhe organizimi i përgjithshëm i Shërbimit

Korrektues, kushtet e veçanta apo shtesë për rekrutim e shumëcka tjetër. "Po ashtu, me këtë ligj është paraparë themelimi i disa njësive të reja të nevojshme për veprimtarinë e ShKK-së. Përgjatë dy viteve të fundit, me përkrahjen e Ambasadës Amerikane, janë trajnuar dhe certifikuar 104 zyrtarë në fusha të ndryshme dhe, po ashtu, me qëllim të ngritjes së kuotës gjinore në radhët e stafit korrektues, sot me sukses po certifikon edhe 45 zyrtare korrektuese gra, si gjeneratë e 43 e ShKK-së. 70 kandidatë për zyrtarë korrektues janë në proces të rekrutimit të cilët do t'i ndjekin trajnimet për avancim dhe zhvillim në fusha profesionale. Në proces është edhe themelimi i Institucionit për Trajnimin dhe Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta", ka thënë Kurti. Synimi ynë, tha më tej kryeministri, është që të gjithë të burgosurit, të gjithë ata që vuajnë dënimin, një ditë kur ta kenë përfunduar atë të integrohen në shoqëri më të mirë, më të drejtë, më të aftë sesa që ishin më herët.

Në përmbyllje të fjalës së tij, kryeministri Kurti veçoi se përgatitjet nuk do të mungojnë, profesionalizimi vetëm sa do të shtohet, kujdesi dhe siguria do të janë prioritet, dhe trajtimi dinjito i të gjithëve pa dallim do të jetë i përhershëm.



# Gërvalla: Draft-statuti i Asociacionit s'është shumë i mirë, por është një bazë e mirë për të punuar me të

Ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, ka thënë të premten se draft-statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nuk është shumë i mirë në përbajte, por një bazë e mirë për të punuar me të. Ajo ka theksuar se ky draft nuk ofron asnjë lloj autonomie për veriun e Kosovës. "Drafti ka mjaft sfida, respekton shumë prej shqetësimeve tona në të kaluarën dhe mendoj se është një bazë e mirë për të punuar me të. Ju siguroj se nuk ka asnjë tentativë, asnjë përpjekje, asnjë vullnet dhe as dëshirë të kësaj qeverie, në përgjithësi të institucioneve për të pranuar drafte të cilat janë në dëme të Kosovës", është shprehur Gërvalla

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Draft-statuti i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, i pranuar në parim nga Qeveria e Kosovës javë më parë, sipas ministres së Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, nuk është shumë i mirë në përbajte, por një bazë e mirë për të punuar me të. Në një prononcim përpara gazetarëve, kryediplomatja ka theksuar se draft-statuti i Asociacionit, i cili ka ende statusin konfidencial dhe publiku nuk mund ta shohë edhe për një kohë, "respekton shumë prej shqetësimeve tona". "Drafti nuk ofron asnjë lloj autonomie për veriun e Kosovës dhe nuk është fer pyetja sepse përgjigja nuk varet nga ne. Po të ishte për ne si Qeveri e Republikës së Kosovës menjëherë të nesërmend do ta kishim publikuar. Është kërkësë e atyre që merren me procesin e negociatave.

## Gërvalla paraqet projektbuxhetin e MPJD-së për vitin 2024

Ministrja Gërvalla të premten ishte e ftuar në mbledhjen e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë,

ku u shqyrtua Projektligji mbidarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 lidhur me fushën në fushëveprim të këtij komisioni. Fillimisht, kryetarja e komisionit, Arbëreshë Hyseni-Kryeziu, përmendi investimet e qeverisë për blerjen e objekteve për misionet diplomatike të Kosovës. Më pas ajo kerkoi sqarime nga ministria Gërvalla, lidhur me blerjen e objektit për nevoja diplomatike në Strasburg, duke kerkuar tutje të dhëna më të hollësishme rreth planit për këtë çështje meqë, shtoi ajo, është fokus i veçantë i MPJD-së ndarja e mjeteve për objektet diplomatike.

Ministrja Gërvalla gjatë prezantimit të saj paraqiti projektbuxhetin e MPJD-së për vitin 2024 si dhe përbloindi të arriturat dhe sfidat e kësaj ministrie përgjatë këtij viti. Duke u fokusuar tutje në buxhetin e ndarë për këtë ministri për vitin 2024, me theks të veçantë ajo foli

lidhur me blerjen e objekteve përmisionet diplomatike të Kosovës. Po ashtu, ministria Gërvalla paralajmëroi se shumë shpejt do të përfundojë edhe blerja e ndërtesës për Ambasadën e Kosovës në Kroaci, duke vënë në pah optimizmin e saj edhe për blerjen e objektit në Strasburg, si dhe fokusimin e ministrisë te vendet e Quintit.

Pas prezantimit të ministres Gërvalla, anëtarët e komisionit ngritën një sërë çështjesh të cilat ndërlidhen me punën dhe buxhetin e kësaj ministrie.

Anëtarja e komisionit, Fitore Pacolli, përvëç blerjes së objekteve për ambasadën, kerkoi të dhëna edhe rreth objektivave të kësaj ministrie si dhe përshtim të stafit. Anëtarja tjetër e këtij komisioni, Yllëza Hoti, pyeti ministren Gërvalla rreth subvencionimit dhe përfshirjes së të rinjve nga diaspora në projektet e ardhshme.

Më tutje, Gazmend Gjyshinca, anëtar i këtij komisioni, kerkoi më shumë informata nga ministria Gërvalla, lidhur me zgjerimin e misioneve të reja diplomatike të Republikës së Kosovës.

Ndërkaq anëtarja e komisionit, Ariana Musliu-Shoshi, shfaqti një varg kritikash për ministren Gërvalla, lidhur me raportimin e saj në këtë komision, si dhe për blerjen e objekteve për ambasadën. Po ashtu, ajo kerkoi të dhëna nga

Gërvalla rreth këshilltarëve të saj dhe për të ardhurat e diplomatave. Pas shterimit të diskutimit, anëtarët e komisionit me shumicë votash përkrahën projektbuxhetin e MPJD-së për vitin 2024.

**Paga 7 500 euro për Gani Jakupin, Gërvalla:**  
**Shumë modeste për një personalitet të rëndësishëm kulturor**

Paga prej 7 500 eurosh që Ministria e Punëve të Jashtme ia jep në muaj artistit Gani Jakupi është një shumë modeste, ka thënë ministria Donika Gërvalla, kur ka raportuar në komisionin parlamentar për punë të jashtme. "Nuk është pagë mujore, është shuma e cila përfshin shpenzimet e një projekti të tërë njëveçar dhe e cila është një shumë modeste krahasuar me shumat që janë paguar përllobim në Afrikë dhe në shtetet e tjera", shpjegoi ajo. Ajo është shprehur krenare që dikasteri të cilën ajo e drejton me një shumë kaq modeste ka angazhuar një personalitet të shquar kulturor. "Po e përsëris, kjo nuk është pagë. Është një shumë e një projekt lidhur me objektiva të qarta të përcaktuara saktë, i cili i shërben Republikës së Kosovës dhe vendosjes së saj nëpër vende jonjohëse kryesish", potencoi ajo.

# KE-ja do t'i përgjigjet qeverisë për heqjen e vizave për shtetasit e Kosovës me pasaporta të Serbisë

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Komisioni Evropian nuk u ka dhënë përgjigje pyetjeve specifike rreth propozimit që edhe bartësit e pasaportave të Serbisë që jetojnë në Kosovë të përfshihen në liberalizimin e vizave.

Në prill të këtij viti KE-ja kishte theksuar se liberalizimi i vizave i miratuar për Kosovën vlen vetëm për poseduesit e pasaportave të Kosovës dhe jo për ata qytetarë që kanë pasaporta të Administratës Koordinuese, e cila punon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Por, në propozimin e ri, KE-ja ka argumentuar se tashmë nuk ekzistojnë arsyë për shkak të të cilave ishte vendosur që bartësit e pasaportave të Republikës së Serbisë me vendbanim në Kosovë të mos kenë mundësi të udhëtojnë pa viza, për dallim nga shtetasit e Serbisë me vendbanim në Serbi.

Zëdhënësja e Komisionit Evropian për çështje të brendshme, Anita Hipper, ka paralajmëruar se komisionarja për Punë të Brendshme, Ylva



Johanson, do të mund të përgjigjet në letrën dërguar nga ana e Qeverisë së Kosovës. "Komisioni Evropian më 16 nëntor ka miratuar propozimin me qëllimin për ta siguruar përfshirjen e të gjithë qytetarëve të Ballkanit Perëndimor në mundësinë e udhëtimit pa viza në BE. Komisioni eshtë në pritje që kjo të miratohet nga ligjvénësia në BE", i eshtë përgjigjur ajo pyetjes se cili eshtë qëndrimi i Komisionit Evropian duke iu referuar letrës që Qeveria e Kosovës i ka dërguar

dëhënë Qeveria e Kosovës dhe disa organizata joqeveritare nga Kosova, se me këtë propozim Komisioni do ta pengojë integrimin e serbëve në Kosovë dhe se një e gjë e tillë shkel integritetin territorial të Kosovës. "Sa i përket çështjes së dytë, ajo do të përcillet nga komisionarja Johanson në përgjigjen e saj për pyetjen specifikë", ka thënë zëdhënësja e Komisionit Evropian duke iu referuar letrës që Qeveria e Kosovës i ka dërguar

Komisionit Evropian.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, më 20 nëntor i ka dërguar një letër Komisionit Evropian dhe Këshillit të BE-së ku thotë se ky propozim shkel sovranitetin e Kosovës, pengon integrimin e serbëve në Kosovë dhe hap rrezikun e përdorimit të të dhënavë të pasakta çka paraqet edhe kërcënëm të sigurisë.

"Lëshimi i pasaportave nga Qendra Ilegale Koordinuese e Serbisë, që i konsideron komunat në Kosovë si pjesë e juridiksonit të Serbisë, eshtë shkelje serioze e sovranitetit", thuhet në letrën e

Qeverisë së Kosovës, ku rikujtohet se Bashkimi Evropian e ka konsideruar Kosovën si të vërtin autoritet legitim për regjistrin civil me të drejtë të lëshimit të pasaportave për qytetarët që jetojnë në hapësirën e saj.

Qeveria e Kosovës ka hedhur poshtë pohimet se serbët nuk do të përfshiheshin në liberalizimin e vizave pasi ata, me procedurë të përspejtuar dhe të thjeshtëzuar, mund të pajisen me pasaporta të Kosovës.

Në letrën e Qeverisë së Kosovës jepen edhe shifrat, sipas të cilave, vetëm në dhjetë muajt e parë të këtij viti 4 350 serbë të Kosovës kanë marrë pasaporta të Kosovës, që është rritje prej 29-përqindësh krahasuar me vitin e kaluar.

Lidhur me propozimin e KE-së kanë reaguar më herët gjatë 21 nëntorit edhe mbi 20 organizata të shoqërisë civile.

Përmes një letre të hapur drejtuar Ylva Johansson, komisionares evropiane për Çështje të Brendshme, shoqëria civile ka kërkuar që KE-ja ta térheqë propozimin.

Nga 1 janar i vitit 2024 qytetarët e Kosovës pritet të udhëtojnë pa viza në 27 vende të BE-së, të cilat e përbëjnë të ashtuquajturën Zonë Shengen.

Pasi të hyjë në fuqi liberalizimi i vizave për bartësit e pasaportave biometrike të Republikës së Kosovës, bartësit e pasaportave të Serbisë me vendbanim në Kosovë, nëse propozimi i KE-së nuk jetësohet, do të mbeteshin të vërtit pa mundësinë e lëvizjes pa viza.

## Kurti: I takon BE-së ta publikojë draft-statutin e Asociacionit

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se nuk është ai i cili duhet ta publikojë draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Këtë, sipas tij, duhet të bëjë ndërmjetësi evropian. Propozimi i zyrtarëve perëndimore përmim të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë u është paraqitur Kurtit dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiç më 21 tetor nga përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara (ShBA), Bashkimit Evropian (BE), Francës, Germanisë dhe Italisë. "Tash i përket ndërmjetësit [BE-së], i përket ndërmjetësit evropian që ta bëjë publik draftin dhe kjo është arsyja pse unë nuk i bëj dot publike vërejtjet dhe kritikat e mia. Besoni që ka aktorë të ndryshëm që mezi presin unë të bëj shkelje të procesit dhe procedurave dhe kjo do ta dëmtonte përfaqësimin e Republikës së Kosovës. Sa përmua le ta publikojnë edhe draft-statutin, e kësosoj të hapet edhe rruga për të publikuar edhe ne vërejtjet e kritikat tonë", tha Kurti para gazetarëve të premtën në Prishtinë.

Kurti përsëriti se më 26 tetor, në takimin në Bruksel me liderët

evropianë, ka shprehur gatishmërinë për ta nënshkruar "paketën, jo njërin prej teksteve" që, sipas tij, nënkupton së pari Marrëveshje Bazike, Aneksin e zbatimit dhe pastaj draft-statutin. Ndërkaj, në fillim të këtij viti arritën marrëveshjen drejt normalizimit dhe aneksin për zbatimin e tij. Marrëveshja, prej 11 nenesh, mes të tjera, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradit t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të dialogut.

Sipas Kurtit, duke refuzuar nënshkrimin, Serbia nuk dëshiron asocion për serbët e Kosovës, por "kundër Kosovës". "U lëshua një shans unik e i Jashtëzakonshëm që të vuloset normalizimi. Me këtë rast, më lejonit të theksoj që nëse Serbia do të ishte e interesuar për normalizim, përvëç që nuk do ta shkelte Marrëveshjen Bazike të 27 shkurtit, njëkohësisht ajo do të bënte hapa të përparimit sa i përket kapitullit 35 të negociatave për anëtarësim në Bashkim Evropian", tha Kurti.



Jakupi, sipas Gërvallës, është angazhuar në kuadër të diplomacisë kulturore dhe në kuadër të projekteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme për të krijuar, siç tha ajo, "një ambient tjetër në vendet jonjohëse". "Si ministre shfrytëzoj të gjitha instrumentet

natyrish duke kursyer buxhetin e shtetit, sepse lehtë është të angazhosh një kompani që kushton 4 milionë euro, por vështirë është të gjesh personalitetet të rendësishme kulturore dhe publike". Gërvalla ka tentuar të amortizojë

këtë shumë duke thënë se qeveritë e mëparshme kanë paguar edhe 50-fish më shtrenjtë për shërbime të njëjta. "Sa i përket pagës prej 7 500 eurosh, pikërisht partia që ju përfaqësoni ka paguar 50-fishin. Me PDK-në hezitoj të diskutoj përfinanca. Unë ju dëgjoja sepse ju e

shfrytëzoni mikrofonin vetëm për të bërë gjënjeshtra. Kjo nuk është pagë. Është një projekt i lidhur me objektiva të qarta", ka theksuar ajo. Mediumi "Periskopi" ditë më parë kishte raportuar se 7 500 euro është paga me të cilën Gani Jakupi paguhet nga Qeveria e Kosovës për


pozitën këshilltar në Ministrinë e Punëve të Jashtme. "Periskopi" raportoi se Jakupi jeton në Spanjë, por është angazhuar nga ambasadori i Kosovës në Bruksel, Agron Bajrami, si këshilltar i Jashtëm për çështje kulturore dhe mediatike.

## Komuna e Rahovecit lanson hartën e lirisë

**RAHOVEC, 24 NËNTOR** - Në kuadër të platformës elektronike "Rahoveci digital", në prag të festave të nëntorit është lansuar edhe një projekt shumë i rëndësishëm "Harta e lirisë". Në këtë hartë janë paraqitur lapidarët e dëshmorëve, varrezat e

dëshmorëve, varrezat e martirëve, pikat e zjarrit të UÇK-së, barrikadat, ambulancat, muzetë, shtëpitë që kanë shërbyer si shtabe të UÇK-së, shtëpitë që kanë shërbyer si baza të organizimit, strehë dhe logistikë të UÇK-së. Komuna e Rahovecit ka

njoftuar se harta është realizuar me programe bashkëkohore digitale dhe hartografike, në bashkëpunim mes OVL - Dega në Rahovec, Idriz Shala - ekspert i hartografisë, zyrtarët e komunës nga zyra e IT -së dhe kompania "Rama Print".



## Lulzim Tafa dekorohet nga presidenti francez Emmanuel Macron

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Rektori i Kolegjit AAB, Lulzim Tafa, njëherësh një ndër poetët kosovarë më të njohur në botë, është dekoruar nga shteti francez si "Oficer i Urdhrit Kombëtar të Letrave dhe Arteve".

Kjo dekoratë është më e larta në fushën e artit dhe letërsisë nga Franca, ndërsa është edhe dekorata më e lartë të cilën e ka marrë deri tani ndonjë shkrimitar nga Kosova.

"Urdhri Kombëtar të Letrave dhe Arteve" e jep Ministria e Kulturës e Francës që nga viti 1957 dhe është nën përkujdesjen e presidentit të Republikës së Francës.

Tafa është një nga poetët më të njohur kosovarë në botë. Veprat e tij janë përkthyer në rrith tridhjetë gjuhë të botës, ndërsa është vlerësuar nga kritika letrare botërore si një nga poetët kryesorë postmodernistë të Evropës.

Kohën e fundit Lulzim Tafa është bërë i njohur edhe për artin e tij në shërbim të paqes, në veçanti para shpërthimit të luftës në Ukrainë

me poezinë "Fol me poetët rusë" si dhe me letrat dërguar shumë artistëve dhe shkrimitarëve rusë me lutjet që të ndikojnë te politika që ta parandalojnë luftën.

Si rezultat i përpjekjeve të tij kundër luftës me anë të poeziës ai është nderuar nga shumë institucione kulturore dhe arsimore edhe në Ukrainë, ku është dekoruar edhe nga Patriarku i Ukrainës, Patriarku Filaret, me urdhri "Yuri i Shenjtë Fitimtar".

Lulzim Tafa, po ashtu, ka fituar shumë çmime prestigjioze ndërkombëtare, mban shumë tituj nderi në akademi dhe universitetë ndërkombëtare.

Ndër të tjera, është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Evropës si dhe anëtar i Akademisë së Shkencave, Arteve dhe Letërsisë në Paris.

Ceremonia e dekorimit të poetit Lulzim Tafa me urdhri "Oficer i Letrave dhe Arteve" do të bëhet me ceremoni zyrtare në Rezidencën Franceze në Prishtinë.



## Bulliqi pret në takim menaxherin regional të Postës, diskutojnë për shërbimet postare që ofrohen në Podujevë

**PODUJEVË, 24 NËNTOR** - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka zhvilluar takim me menaxherin regional të Postës së Kosovës, Flamur Kadriu, zyrtarin financiar Altin Hoxha dhe menaxheren e Postës në Podujevë, Shemsie Vokri.

Gjatë këtij takimi është diskutuar lidhur me shërbimet postare që ofrohen në komunën e Podujevës si dhe është diskutuar për nevojën e avancimit të këtyre shërbimeve duke bërë digjitalizimin e shërbimeve dhe përmirësimin e

shërbimeve postare. Kryetari Bulliqi shprehu gatishmërinë për bashkëpunim si institucion komune me qëllim të lehtësimit të punës së Postës së Kosovës në terren me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve të këtij institucioni.

## Ambasadori hungarez viziton komunën e Prizrenit, me Totajn bisedojnë për turizmin

**PRIZREN, 24 NËNTOR** - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të premtën në takim ambasadorin e Hungarisë në Kosovë, Bela Bozsik, me bashkëpunëtorë, me të cilin kanë diskutuar për shumë tema me interes të dyanshëm. Gjatë kësaj vizite, e para te një kryetar komune si ambasador, Bozik shfaqi mbështetjen e tij për procesin e integrimit evropian të Kosovës.

Zhvillimi i biznesit dhe i turizmit mes dy vendeve ishte ndër çështjet kryesore që u biseduan. Gjithashtu, ambasadori Bozsik njoftoi se qeveria hungareze ndan 75 bursa për vitin 2024, për studime bachelor dhe master për studentët e Kosovës, me ç'rast shfrytëzo rastin t'u bëjë thirrje studentëve prizrenas për aplikim dhe vazhdim të studimeve në Hungari.



## Krasniqi: Më shumë se 650 mijë qytetarëve u është rritur norma e interesit të kredive vitin e fundit

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka publikuar të premten shifrat e fundit që ka publikuar Komisioni Evropian në raportin për Kosovën sa iu përket kredive të qytetarëve dhe goditjen e tyre nga rritja

e normave të interesit. Sipas raportit të Komisionit Evropian, normat e interesit të kredive gjatë vitit 2022 janë rritur në 6.3 për qind derisa një vit më parë ishin më të ulëta. Krahas ngritjes së çmimeve, edhe kjo rritje e normave të interesit të kredive ka prekur

më shumë se 650 mijë qytetarë të Kosovës. "Mbi 650 mijë qytetarë të Kosovës, të cilët kanë kredi, krahas rritjes së çmimeve, duhet të përballojnë edhe rritjen e normave të interesit të kredive! #Regres", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



## EULEX-i përforcon kapacitetin e tij këshillues dhe monitorues për në veri



EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Një Ekip i Specializuar (ES) prej gjashtë këshilltarësh policorë u dislokuar në Kosovë për ta përforuar kapacitetin këshillues dhe monitorues të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjt në Kosovë (EULEX), në përpunë me mandatin e EULEX-it për t'i mbështetur institucionet e përgjedhura të sundimit të ligjt në Kosovë, në rrugën e tyre drejt rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë, shumeticitetit dhe llogaridhënieve, pa ndërhyrje politike dhe në përpunë me standarde ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe praktikat më të mira evropiane. Në mënyrë të veçantë, ES e

EULEX-it do ta këshillojë Policinë e Kosovës se si t'i kryejë më mirë aktivitetet e rregullta policore gjatë parandalimit dhe luftimit të krimit dhe ofrimit të sigurisë, duke e monitoruar gjithashtu respektimin e detyrimeve të tyre për të drejtat e njeriut, për tu shërbyer komuniteteve që ata i mbrojnë dhe për ta rritur besimin e popullatës përmes punës policore të orientuar në komunitet.

Dislokimi i ES të EULEX-it do të zgjasë fillimisht për dy muaj, me mundësinë e vazhdimit derisa misioni ta ketë krijuar një kapacitet afatgjatë këshillues policor në veri të Kosovës. Pjesëtarët e ES të EULEX-it janë të dërguar nga Holanda (tre) dhe Suedia (tre) dhe, duke u bazuar në përvojën dhe ekspertizën e

tyre policore në komunitet, do të punojnë në komunat veriore në koordinim të ngushtë me kolegët e tyre të Policisë së Kosovës dhe me Këshilltarët e Lartë Policorë të EULEX-it, të cilët e këshillojnë Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicën e Veriut dhe katër stacionet policore nën komandën e saj.

Dislokimi i Ekipave të Specializuara me ekspertizë dhe kapacitete të ndryshme është një instrument i ofruar nga Kompakti i Politikës Civile të Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje (CSDP), i miratuar në maj 2023 për të dislokuar shpejt ekspertë në Misionet Civile të CSDP-së për t'u përgjigjur me shpejtësi nevojave operacionale dhe zhvillimeve të sigurisë në terren.

## Kushtetuesja e rrëzon në tërësi Ligjin për masat e përkohshme të produktave themelore

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar Ligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg, të cilin LDK-ja e kishte dërguar në kushtetuese për shqyrtim.

Në njoftimin e Kushtetueses është thënë se ligji në fjalë duhet të shpallet i pavlefshëm në tërësinë e tij. "Në fund, aktgjyki i sqaron që kërkesa e parashtruesve të kérkesës është parashtruar në gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 (Juridikioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës dhe se kjo kategori e kérkesave ka karakter suspenziv, përkatësisht ligji i tillë mund t'i dërgohet presidentit të Republikës së

Kosovës për shpallje vetëm pas vendimmarjes së gjykatës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të gjykatës për rastin e kontestuar. Në kontekst të praktikës së saj gjyqësore, siç është shtjelluar edhe në aktgjykim, gjykata vlerëson që marrë parasysh natyrën e dispozitave të ligjt të kontestuar të shpallura në kundërshtim me Kushtetutën dhe faktin që pjesa tjetër e ligjt të kontestuar do të ishte vështirë e zbatueshme pas shpalljes së dispozitave të lartëkura si të pavlefshme, Ligji i kontestuar, në shërbim të parimit të sigurisë juridike, duhet të shpallet i pavlefshëm në tërësinë e tij", është thënë në njoftimin e Gjykatës Kushtetuese.



## Të hënën FSK-ja organizon "Ditën e Hapur"

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, me rastin e Ditës së Forcës, të hënën, me datë 27 nëntor, duke filluar nga ora 10:00 deri në orën 13:00, organizojnë "Ditën e Hapur". Manifestimi qendror do të mbahet në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, ku do të marrin

pjesë udhëheqësit më të lartë shtetërorë si dhe përfaqësuesit ushtarakë e diplomatikë të vendeve partnerë me mision në vendin tonë.

Deklarimi për medie i personaliteteve të larta shtetërore, me rastin e Ditës së Forcës, do të bëhet me fillim nga ora 11:50-12:10. Në

këtë ditë festive të gjithë qytetarët janë të mirëpritur në të gjitha kazematat e FSK-së, si në: Prishtinë, Mitrovicë, Istog, Gjilan, Prizren, Ferizaj dhe Pomoçatin, ku do të ekspozohen pajisje, armatime, demonstrime si dhe aktivitete të ndryshme, që dëshmojnë kapacitetet e FSK-së.



## Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane hap zyrë në Kosovë

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane ka hapur zyrë në Kosovë. Në ceremoninë e hapjes së kësaj zyre kanë marrë pjesë kryetari i këtij unioni, Nazmi Viqa, filantropi Lazim Destani, përfaqësues të partive politike dhe kryetarë komunash.

Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se hapja e kësaj zyre është moment jetik për Kosovën. Sipas tij, kjo zyrë do të ketë ndikim në hapjen e vendeve të reja të punës. "Shumë të rinj e të reja

shqiptarë, që dikur u detyruan ta lëshojnë atdheun për shkak të kohëve të vështira, iu përveshën punës e u bënë të zotë. Sot në Gjemanit janë dhjetëra biznese të suksesshme. Ato kanë arritur që në bashkëveprim ta irritin potencialin e tyre në tregun gjerman e më gjérë, por edhe ta ndihmojnë ekonominë e Kosovës përmes projekteve të ndryshme. Sot, së bashku me kolegët Ardian Gjini dhe Ukë Blakaj, u pritëm nga Kryesia e Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, kryesuar

nga kryetari Nazmi Viqa dhe, po ashtu, nga kryetari i Nderit i këtij unioni, Lazim Destani. Hapja e zyrës së Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në Kosovë është një moment krenarie. Një mundësi e mirë për zgjerimin e veprimitarës së tyre në favor të zhvillimit dhe shtrirjes së bizneseve të diasporës në vendlindje dhe bashkëpunimit ekonomik me kompanitë e Kosovës, një moment jetik për hapjen e vendeve të punës dhe qëndrimin e të rinjve në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

## HAPJA E ZYRËS NË KOSOVË



## Kurti: Ekonomisë së vendit secilin vit i shtohen mbi 1 miliard euro nga ndërmarrësit

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka dekluaruar se bashkëpunimi në mes të sektorëve është i nevojshëm në mënyrë që të zhvillohet ekonominë e vendit. Për këtë ai tha se do ta kenë çdoherë mbështetjen e qeverisë.

Kurti në konferencën për dialogun publiko-privat që po mbahet me mbështetjen e Qeverisë zvicerane dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka theksuar se ekonomisë së vendit secilin vit i është shtuar mbi 1 miliard euro, përcakta se kjo rritje padishim është rezultat i ndërmarrësisë së sektorit privat. "Konkurrencën dhe

bashkëpunimin duam t'i shohim bashkë. I gjithë sektori privat e ka të garantuar aleatin dhe partnerin në mënyrë që ta ndihmojmë njëritjetrin në këtë drejtë, të prodhojmë e të eksportojmë më shumë, ta luftojmë informalitetin më shumë dhe ta përforcojmë konkurrencën e vendit tonë. Ne duhet të jemi në këtë dialog edhe mirë të strukturuar në mënyrë që sfidat të definohen saktë, takimet tonë mos të janë biseda që përsëriten, për raportime për rezultatet e arritura. Ekonomisë së vendit i është shtuar mbi 1 miliard secilin vit", ka thënë Kurti.



## Shahini: Në vitin 2024 pritet që rrreth 150 mijë qytetarë ta braktisin Kosovën



**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB) Agim Shahini, ka thënë se në bazë të një hulumtimi nga Institutu "Riinvest", pritet që në vitin 2024, 150 mijë qytetarë të largohen nga Kosova. "Studimi i këtij institucionit i ka vërtetuar të dhënat tona paralajmëruese të studimit. Kjo mesatarisht mund të jetë e përafërt e saktë, sepse nëse janë 360 deri në 380 mijë punëtorë, të cilët aktualisht janë kontributdhënsë dhe fuqia punëtore po ashtu në Kosovë mund të jetë rrreth 850 mijë punëtorë, pjesa tjetër janë të papunë. Kjo del se ajo shifra rrreth 150 mijë qytetarë të vendit

seriozisht do ta rrezikojë Kosovën dhe kjo është një zbrasje. Ata, përfat të keq, nuk janë vetëm punëtorë të papunë, por një numër i tyre janë punëtorë që janë në punë dhe kanë kontrata të punës", ka dekluaruar Shahini.

Ai ka theksuar se, sipas një analize të AKB-së, rrreth 50 mijë punëtorë mund t'i kenë marrë këtë vit kontratat e punës për në vendet e tjera. "Do të thotë, nëse brenda tri viteve kanë ikur 150 mijë me dokumente të rregullta pune, në vitin 2024 do të shkojnë plus edhe 150 mijë të tjera si turistë. Gjermania nga dhjetori ka liberalizuar tregun ku çdo qytetar i

Balkanit Perëndimor, i cili shkon në Gjermani si turist, nëse bie në kontakt me një punëdhënës, ai mund të lidhë kontratë për një kohë shumë të shkurtër", ka thënë Shahini në RTV21.

Ai ka shtuar se në bazë të hulumtimit, përvëç faktorit ekonomik, në iljin e qytetarëve nga Kosova po ndikojnë edhe rrëthanat politike. Duke përmendur sulmin terrorist në Banjskë, sanksionet nga BE-ja, rënien e investimeve të huaja, Shahini thotë se këto kanë ndikuar që qytetarët e vendit të mendojnë se Kosova është në një gjendje të vështirë.

## Kosova dhe Shqipëria diskutojnë përritjen e shkëmbimeve tregtare të produkteve bujqësore

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës, Faton Peci, është takuar të premten me ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj. Gjatë takimit të mbajtur në Tiranë, palët theksuan bashkëpunimin mes dy vendeve në fushën e bujqësisë, rritjen e shkëmbimeve tregtare, sidomos produktet bujqësore

dhe blektorale. "Diskutimet i përqendruam në shkëmbimin e përvjave, teknologjive moderne dhe strategjive, për ta përmirësuar prodhimin bujqësor në të dy vendet dhe sigurinë ushqimore të produkteve, duke synuar të krijojmë një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe në avantazh për të dy vendet në fushën e bujqësisë", u shpreh ministria Denaj.

Gjatë këtij takimi u vendosën disa piketa bashkëpunimi konkretë në aspekte bilaterale të grupeve teknike të punës në mënyrë që të arrihet kursimi i kohës dhe kostove. Përmë tepër u theksua vijimi i bashkëpunimit dypalësh në fushën e agroturizmit, ku paketat e përbashkëta turistike do të janë jo vetëm për shqiptarët në Kosovë, por edhe për turistët e huaj.



Reagim i KMDLNj-së

# Në mungesë të transparencës dhe llogaridhënie besueshmëria në Gjykatën Speciale është në pikëpyetje!



Gjykatë Speciale me seli në Hagë ishte themeluar nga Kuvendi i Kosovës nën një presion të jashtëzakonshëm të ndërkombëtarëve dhe me vullnetin e një pjesë të subjekteve politike kosovare. Me një aneks marrëveshje ku opinioni ishte përfashtuar nga çdo informatë, po kjo gjykatë, tash absolutisht raciste nga aspekti i të drejtave të njeriut i zhveshi, fillimisht themeluesin (Kuvendin e Kosovës) por edhe institucionet tjera të Kosovës nga çdo e drejtë që të kërkojnë transparencë dhëllogaridhënie nga gjykata, ndonëse kjo karikature juridike deklarohet si pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe se punon sipas ligjeve të Kosovës. Ky absurditet, arrogancë dhe shpërsillje ndaj Kuvendit të Kosovës ka krijuar dhe krijon të gjitha kushtet për një proces gjyqësor të pabarabartë, paragjyquesh, të padrejtë ku epilogu thuaja është i ditur, edhe pa përfunduar procesi gjyqësor. Kur të merret parasysh fakti se institucionet aktuale të Kosovës nuk tregojnë asnjë interesim apo vullnet për t'u interesuar nëse pengjeve të Hagës po iu shkelen të drejt elementare të njeriut (raste të tilla ka shumë), atëherë puna e kësaj gjykate thjeshtëzohet në një proces teknik; ekzekutum të një vendimi politik të qendrave të vendosjes botërore. Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë mungesë të guximit minimal që të kërkojnë transparencë dhe llogaridhënie përfaktin se të arrestuarit, të akuzuarit dhe të dënuarit janë 100 përfundimisht të Kosovës dhe 100 përfundimisht janë shqiptarë. Për një çështje që paraqet interes përfundim ka dallime në baza partiake, si gjatë vizitave që iu bëhen pengjeve të Hagës ashtu edhe gjatë prononcimeve. Edhe përfaqësuesit e institucioneve kanë bërë të njëjtat dallime gjatë vizitave ndërsa kanë qenë në një linjë vetëm kur kanë marrë mëditje dhe shpenzime tjera

për vizita ndonëse, në të njëjtën kohë kanë marrë rroga të plota. Për më keq, në vend se ta përbushin detyrimin ligjor që e kanë, angazhohen që t'ua vështirësojnë jetën pengjeve të Hagës. Zyra e Prokurorit të Specializuar përsajesë të provave në Hagë, pas përgjimeve të presidentit Thaci, kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe kryetarit të GP të LV-së, Rexhep Selimi gjatë vizitave familjare dhe me të tjerë si dhe përgjimit të komunikimit elektronik bëri publik një transkript të përgjimit i redaktuar deri në shpërfytyrim (sikur edhe gjatë proceseve gjyqësore) përfshirë kërkuar nga Gjykata Speciale Raciste që të burgosurve t'iu ndalothen vizitat dhe komunikimi sikur që edhe ata të vendosen në dhoma të ndara, pa të drejtë dhe mundësi ta takojnë njëri-tjetrin. Me fjalorë të burgjeve i bien se ata do të veçohen në vetmi, deri në një vendim tjetër. Në bazë të Rregullores së GJSR, përkatësisht pikës 4. vizitat dhe komunikimi me familje nuk mund të ndalothen përvëç në rast të ndonjë epidemie (siç ishte rasti i pandemisë Covid) ku rrezikohet shëndeti i përgjithshëm apo rrezikohet siguria e përgjithshme. Përveç vizitave familjare, as vizitat e avokatëve nuk mund të ndalothen ndërkohë që gjitha masat tjera mund të ndërmerrin nëse ka shkelje të Rregullores dhe Rregullave të Burgut nga të privuarit nga liria. Mund të ndalohet eventualisht vizita e anëtarit të caktuar të familjes (por jo edhe familjes), ndonjë mbrojtësi (por jo edhe të ekspertëve) deri në kohën kur u dënuat me dënim kapital.

Nasim Haradinajt iu mohua pjesëmarrija në varrimin e vëllait që është non sense përgjata e gjykatës së tij. Të gjithë gjykatët e gjykatës së tij janë përfundimisht të dënuarit janë 100 përfundimisht të Kosovës dhe 100 përfundimisht janë shqiptarë. Për një çështje që paraqet interes përfundim ka dallime në baza partiake, si gjatë vizitave që iu bëhen pengjeve të Hagës ashtu edhe gjatë prononcimeve. Edhe përfaqësuesit e institucioneve kanë bërë të njëjtat dallime gjatë vizitave ndërsa kanë qenë në një linjë vetëm kur kanë marrë mëditje dhe shpenzime tjera

dhe Rexhep Selimit por se ka informata se vizitat familjare nuk iu janë ndaluar dhe as kufizuar. GJSR në Hagë, që nga fillimi ka pasur standarde të dyfishata, si përdëshmitarët, ashtu edhe përfshirë burgosurit, të gjithë shqiptarë, të gjithë shtetas të Kosovës.

Dëshmitë dhe dëshmitarët janë siguruar nga Serbia sikur edhe "provat" përgjim, jo rullë edhe nga radhët e BIA-së, policisë serbe, prokurorisë dhe gjykatave serbe. Janë marrë si dëshmitarë të besueshmëri shqiptarë të trajnuar në Serbi e që janë kthyer në Kosovë, "analistë" dhe "veprimtarë të shoqërisë civile", sidomos gjatë vazhdimit të masës së paraburgimit. Janë marrë citate nga mediet, intervistat, prononcimet, librat, bisedat private etj. përfshirë shkallën e inkriminimit ndaj pengjeve të Hagës. Janë marrë si të besueshme edhe raportet e organizatave ndërkombëtare (me emër të madh si HRW) ndonëse dëshmitari ka deklaruar se ato raporte janë shkruar nga vetëm një burim, mediet dhe shërbimet serbe dhe të cilat nuk janë verifikuar në terren apo nga një burim tjetër plotësues.

Pengjet e Hagës një kohë ishin të izoluar, nuk lejohej komunikimi midis tyre.

Salih Mustafës përgjithshëm apo shkak se nuk iu ofrua shërbimi shëndetësor me kohë dhe i duhur, iu përkëqësua gjendja shëndetësore shumë.

Hysni Gucatit, i liruar me kusht nuk iu ofrua ndihma mjekësore (operimi përgjithshëm apo shkak të pasojave të luftës) deri në kohën kur u dënuat me dënim kapital.

Nasim Haradinajt iu mohua pjesëmarrija në varrimin e vëllait që është non sense përgjata e gjykatës së tij. Të gjithë gjykatët e gjykatës së tij janë përfundimisht të dënuarit janë 100 përfundimisht të Kosovës dhe 100 përfundimisht janë shqiptarë. Për një çështje që paraqet interes përfundim ka dallime në baza partiake, si gjatë vizitave që iu bëhen pengjeve të Hagës ashtu edhe gjatë prononcimeve. Edhe përfaqësuesit e institucioneve kanë bërë të njëjtat dallime gjatë vizitave ndërsa kanë qenë në një linjë vetëm kur kanë marrë mëditje dhe shpenzime tjera

Askush nuk është hetuar përrjedhje, shitje apo kontrabandim të informatave nga Zyrat e Prokurorit të Specializuar përsajesa të provave përvëce se janë dënuar me dënim drakonike, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

Aakuqt nga Kosova nuk i lejohet ta monitoroje përfshirë afërmë punën e kësaj GJSR, t'i vizitojë të burgosurit dhe të shohë kushtet fizike ku mbahen dhe trajtimin e tyre, të bisedojë me stafin mbajtës dhe menaxhues, të vizitojë shëtitoren, kuzhinën, qendrën mjekësore, bibliotekën dhe objektet tjera që paraqesin interes nga aspekti i të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria. Përralla janë se aty zbatohen standarde të larta të drejtave të njeriut si Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe, paradoksalisht edhe Rregullave të Nelson Mandelës (standarde më të larta të të drejtave të burgosurve sipas kriterieve të Kombeve të Bashkuara) nëse ato nuk iu nënshtronen një monitorimi të pavarrur e që kjo gjykatë nuk e ka lejuar.

Çdo masë shtrënguese brenda një burgu paraqet një dramë më vete përfshirë burgosurit që reflektohet në përkëqësimin e statusit social dhe shëndetit mendor.

Pavarësisht se vizitat familjare nuk janë penguar apo kufizuar (nuk i lejon Rregullorja përvëç raste të caktuar), këto masa shtrënguese do të reflektojnë gjatë çdo vizite familjare sepse konsiderohen se ato mbahen nën trysni dhe kërcënimi, si përfamiljarët ashtu edhe përfshirë gjykatës së tij.

Këto masa shtrënguese do të ndikojnë edhe në përgatitjen e mbrojtës cilësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit. Masat shtrënguese do të ndikojnë edhe dëshmitarët e ardhshëm që nuk do ta kenë një ambient të lirë dhe të sigurt përfshirë dëshmuar, sidomos përdëshmitarët që nuk duan ta përfillin skenarin e Prokurorit të Specializuar përsajim

të provave. Këto masa shtrënguese ndikojnë edhe në opinionin e gjerë në Kosovë duke thelluar ndarjet, edhe ashtu të theksuara.

KMDLNj pret që transkriptët e nxjerrë nga përgjimet (që parashihen edhe me Rregulloren) të janë më sqaruese në të kundërtën kjo mund të konsiderohet si përpjekje e GJSR që të arsyetojë mbajtjen aq të gjatë në paraburgim të pengjeve të Hagës, arrestimet e fundit dhe inkursionin përmes bastisjeve si në kohën e Xhengiz Kanit që po e bëjnë hetuesit anekënd Kosovës duke konfiskuar celulari, PC, libra, publike dhe materiale tjera, pa i dhi në llojet institucionale të Kosovës.

Përfaqësuesit institucionali nuk kanë asnjë interesim përfatim e të burgosurve në Hagë me arsyetim se nuk duan të ndërhynë në drejtësi (kjo është në rregull) mirëpo mandati kushtetues i detyron që të interesohen përspektivën e të drejtave të njeriut, si të privuar nga liria e që ua garantoninë të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare përfshirë drejtat e njeriut.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk mund ta zhbjëjnë këtë gjykatë (disa nuk kanë guxim, të tjerët janë haptas në anën e Gjykatës) mirëpo e kanë detyrim ligjor, njerëzor dhe moral që, si themelues të kësaj gjykatë së tilla që kjo gjykatë është apo nuk është e Kosovës. Nëse mendojnë se është, atëherë duhet të kërkojnë përgjegjësi dhe llogaridhënie në të kundërtën duhet të dalin botërisht dhe të deklarohen se kjo gjykatë nuk ka të bëjë asgjë me Kosovën dhe ta shpallin se nuk është e Kosovës. Atëherë, kjo gjykatë do ta merrte statusin që e meriton dhe që realisht e ka, Gjykatë Speciale Raciste dhe Kolonialiste që edhe konsideron përgjegjës i trajton, jo në bazë të provave por sipas përkatësisë etnike!



## 50 shtete pjesëmarrëse në Evropianin e Xhudos në Prishtinë

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Kampionati i Hapur Evropian i Xhudos vjen si ngjarja më e madhe sportive në vend. Kjo ngjarje do të zhvillohet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë më

16 dhjetor. Deri në 50 shtete pjesëmarrëse me mbi 100 xhudistë/e elitarë/e do të garojnë për çmimin e madh prej 300 000 eurosh në total në të gjitha kategoritë. Kampionati i Hapur

Evropian i Xhudos, "European Championships Open", organizohet në kuadër të programit shtetëror, "Kosova, shtet i xhudos" nga Federata e Xhudos e Kosovës dhe

mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata Evropiane e Xhudos. Federata e Xhudos e Kosovës bëri me dije se hyrja do të jetë falas për të gjithë.



## Ballkani, i pagueshëm në Superligë

EPOKA  
ERE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 24 nëntor - Ballkani i Suharekës nuk po paraqitet mirë vetëm në arenën ndërkontrollare, konkretisht në Ligën e Konferencës, por edhe në Superligën e Kosovës. Skuadra e drejtuar nga Ilir Daja e ka mposhtur Malishevës me rezultat 0-2 në kuadër të javës së 15 në elitë. Në këtë mënyrë kampionët në fuqi e kanë përfocuar edhe më shumë kreun dhe kanë regjistruar fitoren e pestë radhazi.

"Mungesa e Dellovës, Zybës dhe Kuçit, që kishin ndeshje me Përfaqësuesen e Kosovës dhe Malit të Zi, u vërejt. Në pjesën e dytë ishim më të mirë, më të qetë, pas shënimit të golave në pjesën e parë. Malisheva ka ekip simpatik me lojtarë të rinx dhe perspektivë. Pas rikonstruktimit të këtij stadiumi, është këndshëm të



luash futboll në këtë fushë. Mua më vjen mirë sepse vazhdojmë me fitore edhe pse kundërshtari na vuri në vështirësi. Ne kemi lojtarë me goxha cilësi individuale. Në momentin që dalin në raste të pastra duhet të jenë më cinikë, më të saktë para portës. Duhet

t'i shfrytëzojmë rastet që na vijnë", ka thënë pas ndeshjes, Ilir Daja, trajner i Ballkanit. Vendësit e Malishevës janë mbajtur vetëm deri në minutën e 30, kur Nazmi Gripshi e kaloi skuadrën mysafire në epërsi 0-1. Tre minuta para përfundimit të pjesës së parë, Albin Berisha

realizoi golin e dytë dhe të fundit në ndeshje. Në pjesën e dytë gola të tjerë nuk pati dhe Ballkani mori tri pikët e plota. Trajneri i Malishevës, Qëndrim Kida, pas ndeshjes deklaroi: "Kishim një ekip të fortë që në të gjitha elementet e lojës është i rrezikshëm. Në ndërprerje, sulm pozicional, kundërsulme. Ne u përgatitëm për t'i rezistuar, por morëm dy gola të lehtë. Pjesa e dytë ishte e vështirë sepse kemi mundur të pranonim edhe më shumë gola. Në këtë ndeshje nuk kemi mundur të bënim më tepër. Ballkanin e kemi respektuar më shumë sesa që duhet. Ekipi duhet të jetë më agresiv për ta mposhtur një Ballkan të tillë. U desh të ishim më të vëmendshëm në momentet kur i pranuam golat. Kemi kualitet mjaftueshëm për të mos pranuar gola të tillë". Pas tri pikëve të reja, Ballkani përforcon opozitën e parë me

35 pikë, derisa Malisheva mbetet në kuotën e 20 pikëve. Sot (e shtunë) zhvillohen dy ndeshjet e tjera për këtë xhiro në Superligë dhe takohen Fushë-Kosova me Dukagjinin si dhe Feronikeli 74 me Lirinë. Të dielën zhvillohen edhe dy ndeshja të tjera. Derbi i kësaj xhiroje zhvillohet në Hajvali në mes të Prishtinës dhe Dritës, kurse Gjilani e pret skuadrën e Llapit.

### SUPERLIGA

#### Malisheva-Ballkani 0-2

Të shtunën takohen:  
13:00 Fushë Kosova-Dukagjini  
13:00 Feronikeli 74-Liria

Të dielën takohen:  
13:00 Gjilani - Llapë  
13:00 Prishtina - Drita

## Trepça - Peja, derbi i fundjavës në basketball

**MITROVICË, 24 NËNTOR** - Fundjava sjell super derbi nga elita e basketbolit. Padyshim që sfida kryesore e kësaj xhiroje është Trepça - Peja. Pasi nuk arritën ta kalojnë fazën e grupeve të FIBA Europe Cup, të dyja skuadrat janë përqendruar në garat vendore, ku kanë ambicione të mëdha në këtë edicion. Mitrovicasit renditen në vendin e dytë me gjashtë fitore dhe dy humbje, kurse pejanët në vendin e parë me shtatë fitore dhe një humbje, duke e bërë sfidën edhe më interesante të shtunën. Këto dy skuadra u përballen edicionin e kaluar në finale të "play-off"-it, ku triumfan verdhejnjtë, që u

shpallën kampionë, ndërsa "xehetarët" triumfuan në Supercupën e Kosovës, duke mundur pikërisht pejanët. Takimi tjetër i së shtunës është në mes të Bashkimit dhe Istogut. Prizrenasit kanë tri fitore dhe gjashtë humbje, kurse istogasit një fitore e tetë humbje. Pikërisht fitoren e vetme "Djemtë e Bjeshkës" e kanë ndaj prizrenasve. Dueli i parë i së dielës është në mes të Proton Cable Prizrenit dhe Vëllaznimit. Prizrenasit numërojnë dy fitore e gjashtë humbje, kurse kuqezinjtë janë në një formë të lartë, ku kanë pesë fitore radhazi pas katër humbjeve radhazi. Xhiroja

e dhjetë mbyllt me një tjetër derbi ndërmjet Golden Eagle Ylli dhe Sigal Prishtinës. Therandasit kanë pesë fitore dhe katër humbje, ndërsa prishtinasit pesë fitore e tri humbje.

### SUPERLIGA - Java 10

Të shtunën takohen:  
17:00 Trepça - Peja  
19:00 Bashkimi - Istogu

Të dielën takohen:  
17:00 Proton C. Prizreni - Vëllaznimi  
19:00 G. Eagle Ylli - Sigal Prishtina



## Skandali i Gjokoviqit, Federata e Tenisit e Kosovës do të bëjë ankesë në ITF

Prishtinë, 24 nëntor - Federata e Tenisit e Kosovës e ka dënuar fuqishëm provokimin e radhës nga tenisti serb Novak Gjokoviq, pasi në paraqitjen e ekipit të Serbisë në kuadër të Kampionatit Botëror të Tenisit

u lëshuan këngë nacionaliste serbe kundër Kosovës. "Është për keqardhje që provokime të tillë me këngë e veprime nazionale po ndodhin nëpër ngjarje të mëdha sportive, sidomos në Davis

Cup, që është edhe Kampionati Botëror i Tenisit. ITF - Federata Ndërkombëtare e Tenisit, si organizatore e kësaj gare, është përgjegjëse dhe bashkëfajtore për këtë provokim të radhës ndaj

shtetit të Kosovës", thuhet në reagim. Federata e Tenisit paralajmëroi se do të bëjë ankesë në Federatën Ndërkombëtare, Komitetin Olimpik Ndërkombëtar dhe institucione të tjera relevante.



**Verstappen: Kurrë në një skuadër me Hamiltonin**

**ABU DHABI, 24 NENTOR** - Botërori 2023 i Formulës 1 do të mbylljet këtë fundjavë në Abu Dhabi. Një pistë që sjell ndër mend mjaft kujtime, si ajo e dy viteve më parë, kur Max Verstappen shpalaje për herë të parë kampion bote për pilotë. Në xhiron e fundit ai parakalonte Lewis

Hamiltonin, në një garë me shumë polemika për atë vendim që morën komisarët e pistës në lidhje me makinën e sigurisë. Ajo garë bëri që marrëdhënia mes dy pilotëve të jetë jo fort e mirë edhe pse në pistë e jashtë saj respektohen. Duke folur për marrëdhëniën me Hamiltonin

dhe mundësinë që një ditë të dy pilotët të pilotojnë të njëjtën makinë, Verstappen ka deklaruar: "Kjo gjë s'ka për të ndodhur kurrë. Ndaj, herë tjetër mos më pyetni për këtë gjë". "Nuk dua që njerëzit të më thonë për Hamiltonin si shok skuadre, pasi në Formula 1 ka mjaft pilotë



# Sylvinho për 'Eurosport': Shpirti dhe zemra janë sekretet e Shqipërisë

**TIRANË, 24 NENTOR** - Shqipëria siguroi për herë të dytë një biletë për në Evropian, këtë herë me Sylvinhon në stol. Strategu brazilian po përjeton një moment magjik në krye të kuqezinjeve. Ai është kthyer në kryefjalën e medieve më prestigjioze. Sylvinho kthehet pas në kohë duke pranuar se në momentin e parë as që e imaginonte një përfundim të tillë. "Është një èndërr pér mua. Nëse dikush do të më thoshte një apo dy vjet më parë: A do të shkosh te Shqipëria? Do t'i thosha pse? Nuk e di. Pra, ajo që dua të them është se: kur je një trajner, ose dhe lojtar, çdo gjë është shumë e shpejtë. Pëlqej ta përjetoj atë moment. Synimi ynë, èndrra jonë, është ta përgatitim ekipin pér 6-7 muajt e ardhshëm", ka thënë Sylvinho. "Unë besoj shumë te marrëdhënia me lojtarët. E kam thënë edhe më herët, është ndryshe kur në mes futen një përkthyes, është ndryshe kur flet me zemër, kur i sheh në sy lojtarët. Është shumë e



rëndësishme të flasësh me lojtarë të caktuar, por më e rëndësishmajtë zemra dhe shpirti që ke në skuadër. Pa këto nuk mund të luash. Mund të jesh një lojtar i madh, mund të jesh një lojtar

ndryshe, por nëse nuk ke frymën, shpirtin e grupit, nuk mund ta arrish objektivin tënd. Futbolli nuk është një lojë individuale. Është një lojë ekipore”, ka shtuar Sylvinho.

# **'Karagaçi', arenë e derbit të fundjavës**

**PEJË, 24 NENTOR** - E gjithë vëmendja në fundjavë do të jetë në palestrën "Karagaci" në Pejë. Të dielën nga ora 18:00 zhvillohet derbi i madh i Superligës së hendballistëve në mes të Besa Famgasit dhe Rahovecit. Ndeshja i takon xhiros së 11-të të kampionatit të Kosovës. Javë më parë Rahoveci e imposhti Besën për një gol, duke ia shkaktuar humbjen e parë kampionale pas një kohe shumë të gjatë. Rahoveci është lider me 20 pikë, pasi i ka fituar 10 ndeshjet e deritashme. Ndërkohë Besa është e dyta në tabelë, ndërsa ka vetëm atë humbje nga Rahoveci. Të dyja skuadrat kanë shënuar fitore të thella të enjten dhe janë plotësisht gati për spektakël hendballi. Rrjedha e ndeshjes së parë garanton lojë të fortë dhe shumë interesante deri në fund. Nën hijen e derbit në Pejë, në fundjavë janë edhe tri ndeshjet e tjera të xhiros së 11-të. Po të dielën prej



orës 18:00, Vushtrria takohet me Kastriotin. Të shtunën janë ndeshjet Vëllaznimi - Trepça (19:30) dhe Deçani - Prishtina (19:00). Në Ligën e Parë (meshkujt) është javë e tetë. Të shtunën janë

tri ndeshje: Vjosa - Lepenci (18:30), Drita - Prizreni (18:30), Llapi - Ulpiana (19:00). Të dielën janë dy takime. Dukagjini e Istogu luajnë prej orës 13:00, ndërsa Drenica e Samadrexha prej orës 18:00.

**Mourinho: Një ditë do të shkoj të dreitoj në Arabinë Saudite**

Trajneri Jose Mourinho eshtë në sezonin e tij të fundit me Romën, ndërkorë që për të ardhmen e tij situata eshtë ende e paqartë. Portugezi ka pranuar se nuk ka nisur ende bisedimet me klubin për rinoimin e

kontratës, ndaj gjithçka mund të ndodhë korrikun e ardhshëm. Në një deklaratë për medie, "Special One" ka pranuar se një ditë do të drejtojë Arabinë Saudite. Nga Liga Arabe kanë ardhur vitin e fundit disa oferta

për Jose Mourinhon, madje edhe pér ta drejtuar ekipin kombëtar të këtij vendi, por portugezi ka refuzuar gjithnjë, duke deklaruar se do ta respektojë kontratën aktuale. "Mendoj se një ditë do të shkoj të

drejtoj në Arabinë Saudite. Gjithsesi, kur them se do të shkoh aty një ditë nuk bëhet fjalë për nesër apo pasnesër", u shpreh Jose Mourinho, që më pas ka folur edhe për mundësinë e transferimit te Real Madridi.

"Unë te Reali? Ata e kanë një trajner të jashtëzakonshëm, pse duhet të marrin një tjetër. Unë jam një fans i Real Madridit dhe i Carlo Ancelottit. Unë shpresoj që ai të jetë aty edhe vitin tjetër", u shpreh Mourinho.

SHKURT

## **Përfundon sezoni për Betim Fazlijin**

Betim Fazlji ka pësuar lëndim të rëndë. Ai nuk do mund të kthehet në fushë për këtë sezon. Reprezentuesi i Përfaqësueses së Kosovës ka këputur ligamentin e kryqëzuar në gjurin e majtë gjatë stërvitjes. 24-vjeçari do t'i nënshتروhet një intervenimi kirurgjik këtë fundjavë. Lajmin e ka dhënë faqja zyrtare e klubit të tij, St. Gallen. “Betim Fazlji ka këputur ligamentin e kryqëzuar në gjurin e majtë gjatë stërvitjes të së enjtes pasdite. 24-vjeçari do t'i nënshتروhet një operacioni këtë fundjavë dhe do të mungojë për pjesën tjetër të sezonit 2023/24. E gjithë familja e FCSG ju uron, i dashur Betim, operacion të suksesshëm dhe shërim të shpejtë”, thuhet në njoftimin e St. Gallen.

## **Asani: E dua në grup Gjermaninë**

Shqipëria nga 14 qershori do të përfaqësohet në fazën finale të Evropianit, një destinacion i ëndërruar edhe për qindra mijëra tifozë shqiptarë. Një nga lojtarët më meritor që Shqipëria ka arritur në këtë fazë është futbollisti Jasir Asani. Në një intervistë të dhënë për "Top-Channel", ai ka thënë se në fazën e grupeve do të dëshironte që për kundërshtar ta kishte edhe Gjermaninë, vend mikpritës i "Euro 2024". "Gjermaninë do ta doja. Unë e kam thënë që me këtë grup që kemi besoj se na bie një grup i fortë që t'i tregojmë botës se kush jemi, t'i tregojmë botës që kjo Kombëtare ishte surpriza", ka thënë Asani. Shorti për fazën e grupeve të Kampionatit Evropian do të hidhet më 2 dhjetor.

## **Tuchel: E duam Mullerin në skuadër edhe sezoni tjetër**

Trajneri i Bayern Munchenit, Thomas Tuchel, është i bindur se veterani Thomas Muller nuk duhet të tërhiqet nga futboli. Tekniku i gjigantëve të Gjermanisë theksoi së fundmi se 34-vjeçari mund të vijojë të luajë në nivele maksimale ndaj është i mirëpritur për të qëndruar në Bayern edhe për seznonin e ardhshëm. “Ne e duam Mullerin në skuadër. Është e qartë edhe nga ana e vet lojtarit ai kërkon të luajë ende futboll. Pastaj nuk e kuptoj se cila është arsyja që ai të mos vazhdojë në këto nivele të larta që është paraqitur aktualisht? Jam i bindur se mund ta bëjë këtë edhe për seznonin tjetër. Unë e shoh atë të stërvitet dhe të ndihet shumë mirë. Mulleri është një ikonë e këtij klubit dhe ka respektin tonë maksimal”, ka thënë Tuchel.

**Spalletti: E merituam kualifikimin në 'Euro 2024'**

Për gjedhësi i Italisë, Luciano Spalletti, iu kundërpërgjigj kritikeve se skuadra e tij ia "vodhi" Ukrainës kualifikimin në "Euro 2024". Tensionet u ndezën në "BayArena" të hënën pasi Bryan Cristante i Romës u përplas me Mykhaillo Mudryk e Chelseat në zonën e penalltisë në minutat e fundit të ndeshjes. "Ne nuk kemi vjedhur asgjë. Vërtet e kemi merituar kualifikimin në Kampionatin Evropian. Nëse dikush merret me atë incident kundër nesh, nuk është e drejtë, pa e shikuar pjesën tjetër të paraqitjes së ekipit. Ndeshja ishte e vështirë për shkak të presionit që kishte, dhe ai incident mund të jetë i dyshimtë, por sigurisht jo aq i qartë sa shumë njerëz duan të thonë. Zhgjenjvese", ka thënë Spalletti.



Republika e Kosovës  
Repulika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN

Nr. 2253/23

Datë: 24.11.2023

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-212, Ligjt nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Nenit 8 paragrafi 6 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Komuna e Prizrenit, shpall:



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

**Titulli i vendit të punës:** Asistent për fëmijë/nxënësit me nevoja të veçanta.

**Departamenti/Drejtoria:** Drejtoria e Arsimit në Prizren

**Institucioni:** Komuna e Prizrenit

**Numri i Pozitave:** 20

**Titulli i mbikëqyrësit:** Drejtori i Shkollës

**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të pa caktuar

**Koeficienti/Grada:** E22-5

**Në shkollat:**

SHFMU "Emin Duraku" në Prizren – 2 pozita

SHFMU "Fatmir Berisha" në Prizren

SHF "Lekë Dukagjini" në Prizren

SHFMU "Motrat Qiriazi" në Prizren – 2 pozita

SHFMU "Fadil Hisari" në Prizren

SHFMU "Mati Logoreci" në Prizren

SHFMU "Mustafa Bakiu" në Prizren

SHF "Abdyl Frashëri" në Prizren

SHFMU "Ibrahim Fehmi" në Prizren

SHFMU "Hazziz Tola" në Prizren

SHFMU "Xhevat Berisha" në Prizren

SHMU "Gani Saramati" në Prizren

SHFMU "Hysen Rexhepi" në Prizren

SHFMU "Zenun Çocaj" në Gjonaj

SHFMU "Dëshmorët e Zhurit" në Zhur

SHFMU "Dëshmorët e Kabashit" në Korishë

SHFMU "Ekrem Rexha" në Lubizhdë

SHFMU "Svetlosti" në Manastericë (mësim në gjuhën Boshnjake)

**Kualifikimi i kërkuar:** Niveli i 5-të (post secondar) i kualifikimit asistent, përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

#### Detyrat dhe përgjegjësitet:

- Ndihamon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientimin dhe mobilitetin, ndihmon në vendosjen në klasë dhe dorëzimi i fëmijës te personi familjar që e përcjellë atë, në oborrit e shkollës;

- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjeter për zbatimin e PIA-s, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;

- Përgatit materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;

- Vëzhguesh me mësimdhënësit dhe nevojat e identifikuara të fëmijëve, përgatit informata kthyesë për vështirësitet e arritjet e fëmijëve;

- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunitet për pjesëmarrje në lojë, stimulimin e të folmit të gjuhës përmes bisedës dhe lojës;

- Mbikëqyrrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;

- Planifikon me mësues programin ditor dhe javor për mësim, aktivitetet dhe ngjarje me qëllim të mbështetjetë së fëmijëve përmësim;

- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton qështje të ndjeshme me prindërit/kujdestarin;

- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;

- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve;

- Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale;

- Obligohen sipas nevojës të asistojë edhe në ndonjë shkollë tjetër ku ka nevojë.

#### Dokumentacioni i kërkuar:

(në kopje fizike)

- Fotokopja e Letërnjoftimit

- Niveli i 5-të (post secondar) i kualifikimit asistent, përfshirë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (kopja e noterizuar)

- Nostifikimi, nëse kandidati e ka kryer shkollimin jashtë Kosovës

- Ekstrakti i lindjes

- Certifikata që nuk jeni nën hetime

#### Dokumentet që do të kërkohen për kandidatët të cilët përzgjidhen

- Vërtetimi/dëshmia se kandidati nuk ka qenë i dënuar për krim, dhunë ose vepër të padenjë që përfshinë fëmijët.

- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (kandidati/ja e sjell pas përzgjedhjes sipas procedures.

- Të gjitha dokumentet origjinale kandidati/ja i/e përzgjedhur i sjellë për verifikim sipas procedurave.


- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë kalendarike nga data **25.11.2023 deri më 11.12.2023** që konsiderohet si dita e fundit dhe mybillyja e konkursit.

- Aplikimet e dorëzuar pas afatit të parashikuar nuk pranohen dhe aplikimet me mangësi refuzohen.

- Aplikacioni për konkuri merret në faqen e Komunës së Prizrenit. Pas plotësimit sipas çdo pike të aplikimit, bashkëngjithi dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni në Drejtori të Komunale të Arsimit në Prizren.

VËMENDJE: Aplikimet e pranuara pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmije tjeter për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar brenda afatit për dorëzimin e aplikimeve. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siç parashikohet nga legjislacionin në fuqi. Konkursi dhe rezultatet shpalen në web faqen e Komunës së Prizrenit.

**Rezultatet shpalen në linkun:** <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/konkurset-njofitmet/konkurset/>



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpete](http://www.facebook.com/gjejpuneshpete)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

#### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- N.T.P. "Blera M" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810930059.

- Arlind G. Gashi B.I. Frishop Ari shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 812056093.

- Afrim Sahatqija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Marigona Nue nga Doli, KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomen e kl. I-X dhe VI-IX.

- Dea Qerkezi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10. 11. 12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Shaqir Jashari B.I shpall të pavlefshme arkën fiskale me numër UNIK: 811116070.

- Nysret Tunuzliu B.I, shpall të pavlefshme arkën fiskale me numër UNIK: 810002832.

- Imer Himaj nga Osek Hyla KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë Transport Rugorë.

- Bedri Nezaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klm I, II të Gjimanzit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Fisnik Kumnova nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë Gjakovë.

- Ferdane Alidemaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greicevci".

- Ubejd Gashi shpall te pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës me nr. të diplomës 4157.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

